

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Arsyet kanë tejkaluar ligjin'- Gjykata e Lartë e la Veliajn në qeli, avokati Ndreca: Po cenohet mandati i të zgjedhurit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/arsyet-kane-tejkaluar-ligjin-gjykata-e-larte-e-la-veliajn-ne-qeli-avoka-i586367
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 06:51:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 06:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8d0535ca1393a944768c0e844b53537d0545cb89b1b41861c795831d31ce91a6
TEKSTI	3cfafeb538eee5d74641bee840bfa86cdd654c25ba233702f0cadbf3ea429317
PAMJA	28c3681a9eb57048e7b0387786cbcf64453f5d3d416452198a3779226f6bcef6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	721e2d10795cfd60a44344226345faa716da13ca959b1ef8fad9de71513ac32f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	41c8867184070196f446ef02a676766cc2aca397aa3ee03de1cf45e9c1c94b04
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/721e2d10795cfd60a44344226345faa716da13ca959b1ef8fad9de71513ac32f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie 'Arsyet kanë tejkaluar ligjin'- Gjykata e Lartë e la Veliajn në qeli, avokati Ndreca: Po cenohet mandati i të zgjedhuritPrej gjashtë vitesh në qeli, sot vendimi për ish-kreret e fundit

‘Arsyet kanë tejkaluar ligjin’- Gjykata e Lartë e la Veliajn në qeli, avokati Ndreca: Po cenohet mandati i të zgjedhurit



16 Shtator 2026, 08:50Kronika TEMA



Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj do të qëndrojë në qelinë e paraburgimit, me vendim të Gjykatës së Lartë.

Kjo e fundit pavarësisht kërkesës së Gjykatës Kushtetuese, për të argumentuar proporcionalitetin e masës “arrest me burg” në raport me mandatin si kryebashkiak, nuk u bind për lirinë e Veliajt.

Avokati i Veliajt, Plarent Ndreca, pjesë e panelit të mbrëmjes së djeshme në “Opinion”, tha se tashmë arsyet e Gjykatës së Lartë, kanë tejkaluar ligjin.

Ndreca u shpreh se Erion Veliajt po i cenohet pa argumente ligjore ushtrimi i mandatis të kryetarit të bashkisë, e nga ana tjetër, qytetarëve po u mohohet qeverisja nga i zgjedhuri përmes votës.

“Argumenti lidhet me faktin që Veliaj, si çdo qytetar, duhet të plotësojë disa kritere që janë në procedurë penale. Dyshimi duhet të jetë i bazuar në prova që të merret një masë sigurimi. Që të shkosh te arresti me burg, që është ekstrem, duhet të ketë rrezikshmëri shoqërore të lartë, duhet të ketë dyshime të arsyeshme se mund të prishë provat e hetimit, ose rrezikshmëri për të kryer vepër të njëjtë ose më të rëndë. Duhet të shqyrtohet dhe interesi publik, që është e drejta e qytetarëve për t’u qeverisur nga i zgjedhuri përmes votës. Gjykata nuk e kanë marrë në shqyrtim këtë anë të balancës”, tha avokati.

Më tej Ndreca vijoi argumentin:

“Duhet t’i lejohej mundësia për të ushtruar detyrën. Hetimi ka 1 vit që ka përfunduar, praktikisht s’ka asnjë rrezik... Një anëtar i Gjykatës Kushtetuese thotë që nuk ka prova fare. Për sa kohë Kushtetuesja e ka shtruar rrugën, duke i thënë Gjykatës së Lartë se çfarë do të thotë demokraci, i zgjedhur vendor, rëndësia që të mos cenohet mandati. Janë arsye përtej ligjit, është e kotë të kërkohe arsye te vendimi”.

Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj ndodhet në qeli prej 10 shkurtit 2025 dhe ndaj tij ka nisur gjyqi i themelit.

SPAK e akuzon Veliajn për 13 akuza, të tilla si korrupsion pasiv, pastrim parash, mosdeklarim pasurie, shpërdorim detyre dhe futja e sendeve në burg, por

kryebashkiaku i ka mohuar.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[I akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, Gjykata Supreme e Brazilit jep dritën jeshile për ekstradimin e Ervin Matës në Shqipëri](#)

Sadushi dhe Papajorgji në Romë, Mattarella konfirmon pjesëmarrjen në kongresin e drejtësisë në Tiranë

22:30 Kronika

Gjykata Supreme në Brazil shqyrton kërkesën e Shqipërisë për Ervin Matën/ 'Dritë jeshile' për ekstradimin e tij

19:15 Kronika

Zjarr në një fshat në Gjirokastrë, rrezikohen banesat

16:55 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.